



Pranuar / Donesat Prilbena / Prilbato Received / Donesy	23.06.2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	3274/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.497/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-Kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, sipas Aktgjykimit A.nr.2634/19 të datës 27.05.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i protokolluar në Këshill me nr.2834 me datën 02.06.2021, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.480/2019 me numër protokollit 3670/2019 të datës 20.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rr "Ramë Obrangja" nr.22 Podujevë, kundër organit të punësimit- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 23.06.2021, mori këtë .

V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.480/2019 e datës 20.08.2019 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET** vendimi me Nr.630/19 i datës 07.06.2019 për kandidatin e suksesshëm për pozitën zv.Kryeshef Ekzekutiv i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- III. ANULOHET** procedura e rekrutimit për pozitën "Zv.Kryeshef Ekzekutiv i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve" i shpallur më datë 20.04.2019 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.
- IV. OBLIGOHET** Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Kryeshefi Egzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të ndërmarrin të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Sekretariatit të Komisionit Qendror Zgjedhor në pozitën Zyrtar i Lartë Komunal i Zgjedhjeve, me datë 03.05.2019 ka aplikuar në konkursin e shpallur të

datës 20.04.2019 për pozitën Zv.Kryeshef i Komisionit Qendror Zgjedhor, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi Islam Demolli. Me datën 07.06.2019 Paneli përzgjedhës për pozitën Zv. Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve ka rekomanduar z.B.B i cili ka marrë 92 pikë.

Ankuesi i pakënaqur me përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm për pozitën Zëvendës. Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me datë 05.07.2019 ka parashtruar ankesën me nr.703/2019 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me vendimin nr.774/2019 të datës 02.08.2019 e kanë shpall veten jo kompetent.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, më datë 20.08.2019 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3670/2019 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. me pretendimin ankimor se procedura e rekrutimit për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi në të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 25.05.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2634/2019, përmes të cilit ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën A.nr.480/2019 e datës 20.08.2019 të parashtruar nga ankuesi

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.08.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 30.08.2019 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë me të gjitha shkresat e procedurës së zhvilluar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3670/2019 të datës 20.08.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me nr.774 i datës 02.08.2019; Ankesa e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i datës 05.07.2019 me nr.703/2019; Kopja e konkursit; Vendimi me nr.304i datës 15.11.2018 për monitorim i KPMSHCK-së; Vendimi i datës 11.01.2019 me nr.17/2019 për zbatimin e Vendimit dhe Rekomandimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës; Raporti i datës 07.06.2019 Panelit Përzgjedhës për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Njoftim për kandidatit e suksesshëm i datës 07.06.2019; Vendimi i datës 07.06.2019 me nr.630/2019 për emërimin e z.B.B Zv.i Kryeshef Ekzekutiv; Vendim për shpalljen e pozitave të lira në Komisionin Qendror i Zgjedhjeve i datës 11.04.2019; Njoftim për vazhdimin e afatit të konkursit; Regjistri i aplikacioneve të pranuar prej datës 20.04.2019 deri më datën 04.05.2019; Vendim me nr.547/2019 i datës 21.05.2019 për caktimin e panelit intervistues për përzgjedhjen e Zëvendës i Kryeshefit Ekzekutiv të SKQZ-së; intervistimi i

kandidatëve i datës 30.05.2019; Përcaktimi i kritereve për përfshirjen në listën e ngushtë i datës 22.05.2019; Kriteret e vlerësimit të kandidatëve gjatë intervistës me gojë i datës 30.06.2019; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 30.05.2019; E-mail zyrtar i datës 27.05.2019; E-mail zyrtar i datës 29.05.2019 për njoftimin e kandidatëve për pjesëmarrje në intervistën me gojë me datën 30.05.2019; E-mail zyrtar i datës 27.05.2019 i cili njofton se nuk do të marr pjesë në intervistën me gojë për pozitën Zv.Kryeshef Ekzekutiv i KOZ-së; Kërkesa për punësim e datës 03.05.2019 për B.B bashkë me dokumentet e kërkuara; Kërkesa për punësim e datës 03.05.2019 për bashkë me dokumentet e kërkuara;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është pjesërisht e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit dhe të gjitha provat e lëndës, ka konstatuar që kriteret e konkursit për pozitën "Zv.Kryeshef Ekzekutiv i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shpallur më datë 20.04.2019 nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, kanë qenë:

"Diplomë Universitare në Drejtësi, Administratë Publike, Shkenca Politike dhe së paku gjashtë(6)vite përvojë pune duke përfshirë katër(4)vite përvojë menaxheriale."

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se duke u bazuar në kriteret e konkursit, Paneli Zgjedhor i themeluar me Vendimin me Nr. 547/19 të datës 21.05.2019, ka përgatitur listën e kandidatëve të cilët janë intervistuar me datën 30.05.2019 për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në listë është përfshirë edhe ankuesi, i cili në bazë të aplikacionit që ka dorëzuar me rastin e aplikimit po ashtu edhe në bazë të dokumentacionit të dorëzuar tek Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, dhe at dokumentet si në vijim: Kërkesën për punësim të datës 03.05.2019, CV-në, Diplomën e datës 28,06.2008 me nr.123/08 të Fakultetit Ekonomik të lëshuar nga Universiteti AAB, Certifikatën nga Gjykata Themelore në Prishtinë të datës 02.05.2019, Formulari i vlerësimit në punë për vitin 2018, Akt emërimit të datës 01.01.2011, Ndryshimi dhe Plotësimi i Akt emërimit të datës 04.02.2019 dhe Çertifikata të trajnimeve të ndryshme.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, në bazë të provave të lëndës, konstaton se Paneli Zgjedhor i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në përgatitjen e listës së kandidatëve ka bërë shkelje të procedurave të rekrutimit për faktin që ankuesi me rastin e aplikimit në pozitën e lartcekur nuk ka plotësuar kriteret e konkursit sepse ankuesi Z nuk ka përgatitjen profesionale siç kërkohet në kriteret e konkursit "Diplomë Universitare në drejtësi, Administratë Publike, "Shkenca Politike" kurse ankuesi ka Diplomën e datës 28,06.2008 me Nr.123/08 të Fakultetit Ekonomik të lëshuar nga Universiteti AAB, poashtu ankuesi nuk ka as përvojë menaxheriale e që në konkurs kërkohet katër(4)vite përvojë menaxheriale, kështu që përfshirja e ankuesit në listën e ngushtë për pozitën Zv.Kryeshef i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është shkelje e dispozitës së nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: "Anëtar e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional".




Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar që ankuesi nuk ka plotësuar kushtet e konkursit dhe në kundërshtim me dispozitat e lartcekura është përfshirë në intervistën me gojë të datës 30.05.2019, aprovimi i ankesës së ankuesit nuk është bërë për faktin që pretendimet e tij janë të bazuara por është bërë për faktin që kemi konstatuar shkeljet e lartcekura dhe si të tilla kanë bërë që anulimi i këtij konkursi bëhet vetëm për shkeljet e evidentuara si më lartë, sepse e njëjta procedurë është zhvilluar në kundërshtim me nenin 11 paragrafin 1 dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton që: *“Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”* dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si rrjedhojë vendimi me Nr.630/19 i datës 07.06.2019 për kandidatin e suksesshëm për pozitën zv.Kryeshef Ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është i pavlefshëm sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit. Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.497/2021, datë 23/06/2021

Sabile AVDYLI

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Personelit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

